

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë, Sot po diskutojmë projektligjin “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Ajo që mund ta perifrazojë më së miri këtë akt është shprehja “Ishim më mirë, kur ishim keq”. Tani, s’ka ku shkon më keq. Ky projektligj duket si shtojcë e ligjit për informimin publik, që është në fuqi prej vitit 2014, por ndryshe nga ai ligj, ky është një projekt i ri për kufizimin e të drejtës për informacion, një tjetër përpjekje e Edi Ramës për të mos lejuar transparencë, për të mos lejuar informim të publikut si një e drejtë kushtetuese.

Projekti zvogëlon mundësitë e qytetarëve, që të informohen për dokumentet zyrtare në disa struktura specifike shtetërore, siç janë ndërmarrjet publike, Radio Televizioni Publik Shqiptar e disa agjenci të tjera, të cilat edhe pse duket sikur janë larg vëmendjes publike, menaxhojnë miliona euro buxhetore. Pra, “Ishim më mirë, kur ishim keq”, sepse tani çdo ditë bëhet më e keqe dhe më e errët për shqiptarët. Ju kujtohet, para zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit të dhënat personale të qytetarëve, të cilat ata i kishin depozituar në institucionet shtetërore, u shitën, u blenë, u përdorën dhe u keqpërdorën. Nuk mjaftuan 8 vjet qeverisje të Edi Ramës, burgosje, përndjekje, dhunë, shantazhe, shkatërrim të trashëgimisë, grabitje të pronave publike dhe private, largime politike nga puna, varfëri të tejskajshme dhe spastrim të popullsisë dhe qytetarët u vunë përballë presionit të shumanshëm, përballë pushtetit të oligarkëve të bërë palë me krimin, milionave që u hodhën për blerjen e votës, presionit me vendin e punës, bukën e gojës, heqjen ose dhënien e KEMP-it, si dhe me pezullimin e procesit të legalizimit. Po si u bë kjo gjë?

U vodhën të dhënat e çdo votuesi me lejen dhe me porosinë e Edi Ramës. Përpunimi u bë nga AKSHI, dhe u ngrit skema monstruoze e patronazhistëve, si fenomeni më i shëmtuar që po shoqëron çdo zgjedhje. Ju siguroj se mbas 6 marsit Partia Socialiste ka filluar rifreskimin e dhënave edhe mbi bazën e votës së 6 marsit, në ato 6 bashki, ku u zhvilluan zgjedhje. Patronazhimi, e kam thënë edhe më përpara dhe vazhdoj ta përsëris, është krimi më i rëndë elektoral, shkelje flagrante e ligjit për mbrojtjen dhe përdorimin e të dhënave personale, cenim i rëndë i të drejtës kushtetuese për privatësinë, modeli më i përçudnuar i individit të nënshtruar e të keqpërdorur nga qeveria “Rama”. Patronazhisti është rilindja e së keqes, që mendonim se u zhduk bashkë me komunizmin. E kam ngritur shumë herë çështjen e patronazhistëve, madje kam kërkuar në grupin tonë parlamentar (që u mirëprit) ngritjen e komisionit hetimor për hetimin e krimit elektoral, por siç jeni edhe të informuar ky komision u mbyll pa asnjë rezultat, edhe pse kurrë nuk më bënë pjesë të tij, pavarësisht se e kërkova dhe u ofrova të jepja çdo analizë që kisha bërë për funksionimin e skemës së patronazhimit në njësitë ku unë kandidova në Tiranë, pra në njësitë 9 dhe 11.

Rreth 100 mijë votues dhe familjet e tyre kanë qenë të mbikëqyrur, kontrolluar dhe spiunuar nga patronazhistët, që përbëjnë rreth 95% të të gjithë listës së votuesve në këtë zonë. 1200 patronazhistë janë përfshirë në këtë operacion spiunimi, vetëm në këto dy njësi administrative në Tiranë. Puna e patronazhistëve nuk është thjesht një çështje e manipulimit të njerëzve, nuk është thjesht një çështje e të drejtës së privatësisë, por në fakt është çështje e lirisë. Por ajo ka edhe një dimension tjetër të rrezikshëm: përfshirjen e punonjësve civilë në këtë skemë. Patronazhisti në pjesën më të madhe nuk është ai socialisti i ndershëm, që ka besuar gjithë jetën tek e majta apo te partia ku aderon. Jo. Patronazhisti në pjesën më të madhe është nëpunës civil. Dua ta theksoj edhe një herë: punonjësit shtetërorë janë kthyer në spiunë partiakë, për të përgjuar qytetarët e pafajshëm, madje një pjesë e këtyre spiunëve jo vetëm mbledhin informacion, por edhe ndëshkojnë apo shantazhojnë direkt apo indirect.

Në zonat elektorale që unë përmenda pak më lart, Ogerta Manastirliu, ministrja e Shëndetësisë, dhe Ulsi Manja, organizuan me disiplinë ushtarake qindra nëpunës të Ministrisë së Shëndetësisë, të QSUT-së, të bashkisë, të OSHE-së, të UKT-së, të Policisë, të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Arsimit, të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Infrastrukturës e kështu me radhë, nga të gjitha institucionet shtetërore dhe në mënyrë kapilare përgjuan, morën informacion, spiunuan, ushtruan presion mbi dhjetëra, mijëra votues. Më së pari, një qeveri e përgjegjshme, mbasi doli skandali i patronazhistëve nga media “Lapsi.al”, do të kishte kërkuar falje për rrjedhje të të dhënave e më pas vënien para përgjegjësisë të të gjithë zyrtarëve, nga më i larti, deri tek ai i nivelit më të ulët, të cilët vendosën të dhënat personale të të gjithë shqiptarëve në funksion të manovrave elektorale të Partisë Socialiste. Çfarë ndodhi? I pari Kryeministri i mbrojti, i vlerësoi, i falënderoi patronazhistët në mënyrë të veçantë. Përhëndeti skemën tërësisht të ngjashme me atë të anëtarëve të grupeve të bashkuara vullnetare të dikurshme.

Të rinjve sot ne duhet t’u shpjegojmë rolin e tyre dhe ngjashmërinë me patronazhistët e sotëm. Si sot, ato ishin grupe që në çdo qytet, në çdo lagje e grup pallatesh, dinin gjithçka për qytetarët, u hynin në shtëpi, në detajet më intime, i përgjonin, i ruanin, iurvejonin, sajnin dëshmi dhe më tej i përdornin këto informacione për t’u bërë presion, shantazh, por edhe për t’i dërguar në burg apo për të çuar drejt vdekjes këdo që nuk mendonte si partia mëmë apo nuk i bindej çdo urdhri të shtetit komunist. Çfarë janë patronazhistët e sotëm? Njësoj, kanë të njëjtin funksion, janë grupe apo individë të betuar të partisë-shtet, të cilët dinë çdo gjë për banorët e zonës. Informacionin e sigurojnë, as më shumë e as më pak, në bazat e të dhënave shtetërore me porosi dhe urdhër të Edi Ramës. Këta patronazhistë kanë akses të plotë tek të gjitha informacionet që duhet të ishin konfidenciale. Ndryshimi i vetëm nga AGBV-të komuniste, është se patronazhistët nuk kanë forcën për të të burgosur sot, por kanë mundësinë për të të shtrënguar lirinë. Media e shpërtheu skandalin e patronazhistëve.

Të gjithë e pamë se çfarë ndodhi më pas, ku “lideri global” i mori në mbrojtje dhe dha mesazhin edhe për drejtësinë e re, se si duhej trajtuar çështja e patronazhistëve të partisë. Drejtësia e re i kishte provat në dorë, por rendi drejt gazetarëve, që guxuan të publikonin skandalin. Drejtësia e re nuk u thye, as kur Gjykata e Strasburgut e rrëzoi në mënyrë urgjente, si rrallë herë vendimin e saj për të sekuestruar serverët dhe kompjuterët e punës të gazetarëve. Në atë kohë, që nuk është shumë e largët nga sot, ishte ende në fuqi ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, por ndodhi ajo që mund të ndodhte vetëm në një vend nën diktatin autokratik: zero reagim nga institucioni përgjegjës dhe gjithçka u mbyll

me batutat bajate të liderit global. Pasi patronazhistët u shfaqën triumfatorë nën sqetullën e liderit, asgjë nuk e ndalte më rrjedhjen e të dhënave të qytetarëve.

Ne pamë në seri se si pagat, vendet e punës, numrat e telefonit, numrat e pasaportave dhe targat e makinave u shndërruan në një sport masiv në rrjete sociale, duke u kthyer edhe në një krizë sociale. Për çfarë na duhen ligjet kur ato nuk zbatohen, kur ato shkelen, kur informacionet konfidenciale përpunohen e shfrytëzohen me porosi të Kryeministrit, kur ato publikohen dhe patronazhistët marrin merita politike për shkeljet flagrante të ligjit? Këto ligje e humbin kuptimin e tyre kur askush nga titullarët apo zyrtarët e agjencive shtetërore, që administrojnë të dhënat konfidenciale të qytetarëve, jo vetëm nuk është ndëshkuar, por me shumë gjasa merr edhe fletë - lavdërimi. Rrjedhja masive e të dhënave personale është një skandal unikal për nga lloji i vet, jo vetëm në Europë, por edhe në ato vende, të cilat mund të njihen vetëm si nocione gjeografike. Si tallje dhe pa asnjë reflektim, sot qeveria vjen me këtë ligj që po diskutojmë sot, i cili mund të ishte thjesht një amendim i ligjit "Për të drejtën e informimit".

Diskutimi për projektligjin e sotëm mund të ishte një mundësi shumë e mirë për të diskutuar mbi forcimin e masave mbrojtëse për të dhënat e qytetarëve, por ai nuk është as më shumë e as më pak sesa një mekanizëm i ri kufizues për aksesin e qytetarëve në të dhënat publike, ndërkohë që të dhënat personale janë sheshit. Kam bërë denoncime dhe 3 kallëzime penale në SPAK, por ende heshtje, fatkeqësisht nuk ka ndodhur asgjë. As komisioni hetimor nuk nxori gjë në dritë dhe u mbyll në heshtje. Partia Socialiste nuk është hetuar, kurse ministrat, funksionarët, deputetët, që vodhën të dhënat personale, nuk janë dënuar. Sistemi ka mbetur i paprekur. Hetimi i këtij mekanizmi të rrezikshëm spiunimi, ndëshkimi dhe dënimi të fajtorëve duhet të jetë prioriteti i parë i Partisë Demokratike. Nuk duhet të heqim dorë. Nëse nuk shkatërrohet kjo skemë, nëse nuk dënohen personat e përfshirë në këtë krim të rëndë elektoral, nuk do të ketë zgjedhje të lira në Shqipëri. Ky sistem duhet të shkatërrohet dhe qytetarëve më së fundi duhet t'u kthehet liria dhe e drejta të mendojnë dhe të votojnë për kë të duan politikisht. Faleminderit!